



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2021:012822

Datë: 25.03.2024

Numri i dokumentit: 05500812

P.nr.43/2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Marigona Lajqi, me bashkëpunëtoren profesionale Medina Rama, në çështjen penale ndaj të akuzuarit D. V., për shkak të veprës penale Ngacmimi nga neni 186 par.2 në lidhje me par.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë- Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.768/2015 e datës 05.01.2018, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar me datë 01.11.2022, në prezencë të Prokurorit të Shtetit Danjella Batakoviç, të dëmtuarës Z. V. dhe të akuzuarit D. V., me datë 02.11.2022 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 25.03.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

D. V., nga i ati K., e ëma S., e vajzërisë V., i lindur me datë ..., në fshatin V. komuna e Lepasaviqit ku edhe tani jeton, me numër personal të identifikimit ..., i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, serb, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 20.01.2015 në orën 13:00 nga shtëpia e saj e dëmtuara Z. V. ka lajmëruar rastin e ngacmimit në stacionin e policisë në Lepasaviq, të shkaktuar nga ana e të akuzuarit i cili një kohë të gjatë bën shqetësime mendore (psikike) të dëmtuarës, bashkëshortes së tij Z. V. në

mënyrë të sharjeve, ofendimeve, nënçmon me qëllim që të frikësoj të dëmtuarën dhe fëmijët e tij, kështu që vajza e tyre për shkak të stresit të marrë nga ana e të akuzuarit gjatë komunikimit belbëzon, përveç veprimeve të cekura të cilat i akuzuari i ka marrë ditën kritike i njëjti edhe më parë ka kryer dhunë fizike si në të dëmtuarën po ashtu edhe ndaj fëmijëve të tyre.

Me këtë ka kryer veprën penale : Ngacmimi nga neni 186 par.2 në lidhje me par.1 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të neneve: 4, 7, 17, 21, 41, 42, 45, 49, 50, 51, 52, 73, 74, 75 e lidhur me nenin 186 par.2 e lidhur me par.1 të KPRK-së dhe neneve 364, 449, 452 të KPP-së, të akuzuarit, i:

S H Q I P T O N

- I. Dënim me burgim me kusht në kohëzgjatje prej katër (4) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit në kohëzgjatje prej dy (2) viteve, nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.
- II. I akuzuari obligohet që në emër të shpenzimeve procedurale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej njëzet e pesë (25) euro, në emër të fondit të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej njëzet (20) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- III. Pala e dëmtuar Z. V., nuk ka parashtruar kërkesë pasurore juridike.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Mitrovicë- Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.768/2015 e datës 05.01.2018 ndaj të akuzuarit D. V., për shkak të veprës penale Ngacmimi nga neni 186 par.2 në lidhje me par.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 01.11.2022, në të cilën kanë prezantuar Prokurori i Shtetit Danjella Batakoviç, e dëmtuara

Z. V. dhe i akuzuari D. V., ndërsa me datë 02.11.2022, ka bërë shpalljen e aktgjykimit, ndërsa ka mbetur vetëm që të bëhet përpilimi i aktgjykimit.

U.D. Kryetari i Gjykatës, me aktvendimin GJA.nr.42/24 të datës 28.02.2024, ka caktuar gjyqtaren Marigona Lajqi, si gjyqtare të çështjes për përpilimin e aktgjykimit me shkrim, lidhur me lëndën P.nr.43/2018, bazuar në nenin 29 par.1 dhe par.2 nën par 2.2 të Rregullores nr.02/2020 për Organizimin dhe veprimtarinë e brendshme të gjykatave të Republikës së Kosovës duke qenë se gjyqtari i cili ka qenë i ngarkuar me këtë lëndë, ka paraqitur dorëheqje pranë KGJK-së.

Në seancën e shqyrtimit fillestar të datës 01.11.2022 pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, të akuzuarit i është dhënë mundësia që të deklarohej lidhur me fajësinë, ashtu që në këtë seancë i akuzuari lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, është penduar për atë që ka ndodhur, i ka kërkuar falje të dëmtuarës-bashkëshortes Z. V. dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të këtilla apo të ngjashme.

Prokurori i Shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se konsideroj se janë plotësuar kushtet ligjore për pranimin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit, sepse pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe në pajtim me shkresat e lëndës si dhe i ka propozuar gjykatës që t'ia pranoj pranimin e fajësisë dhe të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta gjykoj sipas ligjit.

Pala e dëmtuar Z. V., lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar nuk parashtrij kërkesë pasurore juridike për kompensim eventuale si atë material apo jo material të dëmit, ne jemi pajtuar në vitin 2015 dhe nuk dëshiroj ti bashkëngjitem ndjekjes penale ndaj të pandehurit, kemi raporte të mira familjare, pasi që nuk janë pasur asnjë keqkuptim në mes vete pas këtij rasti. Për sa i përket pranimit të fajësisë jam dakord me fjalët e prokurorit që pranimi i fajësisë të pranohet nga ana e gjykatës.

Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit mbështetet në provat të cilat i disponon kjo gjykatë si Raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2015-SE-008, i datës 20.01.2015, Raporti i Policisë, i datës 20.01.2015, Procesverbali i marrjes në pyetje për të dëmtuarën Z. V. i datës 20.01.2015, Procesverbali i marrjes në pyetje për të dyshuarin D. V., i datës 20.01.2015 si dhe shkresat e tjera të lëndës. Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën

dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë të këtyre provave dhe pranimit të fajësisë, konsiderojmë se përtej çdo dyshimi është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në mënyrë vullnetare, se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, duke i' u tërhequr vërejtja të akuzuarit se pas pranimit të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i akuzuari.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë së të akuzuarit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i akuzuari D. V. ka kryer veprën penale: Ngacmimi nga neni 186 par.2 në lidhje me par.1 të KPRK-së, e për të cilën veprë është paraparë dënimi me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

Me rastin e caktimit të dënimit, gjykata ka aplikuar dispozitat e zbutjes së dënimit, duke qenë se i akuzuari e ka pranuar fajësinë dhe në kuptim të nenit 75 par.1, nën par. 1.3 të KPRK-së, kjo është rrethanë ligjore për zbutjen e dënimit. Megjithatë, me rastin e zbutjes së dënimit janë respektuar kufijtë e zbutjes në kuptim të nenit 76 par. 1 nën par. 1.6 të KPRK-së.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 73 të KPRK-ës. Gjykata, si rrethanë lehtësuese ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale nga i akuzuari në seancën e shqyrtimit fillestar si dhe faktin se me të dëmtuarën që nga viti 2015 i kanë rregulluar raportet në mes vete dhe jetojnë së bashku. Ndërsa, si rrethana rënduese, gjeti mënyrën e kryerjes së veprës penale, si dhe rrezikshmërinë e këtyre veprave penale.

Gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e aktgjykimit, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit. Poashtu gjykata vlerëson se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit, i cili parashihet me nenin 41 të KPRK-së, që të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e

moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, duke vlerësuar se i akuzuari do të përmbahet nga veprimet e paligjshme në të ardhmen.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata e mori në kuptim të nenit 449 par 2 nën par 2.1 dhe 2.6 dhe nenit 452 të KPP-së. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 par. 3 nën. par 3.1 të Ligjit nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 460 të KPPK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 364 dhe 452 të KPPK-ës, nga arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni penal

P.nr.43/2018, datë 25.03.2024

Gjyqtarja e vetme gjykuese

Marigona Lajqi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh prej ditës së pranimit të këtij aktgjykimi përmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.